



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr. 1 Tiranë. E-mail: klsh.org.al; web-site www.klsh.org.al

Nr. 486/ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_. 2018

### V E N D I M

Nr. \_\_\_\_\_, Datë \_\_\_\_\_

### PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË PUSTEC “MBI PËRPUTHSHMËRINË”

**Për periudhën nga data 01.01.2016 deri më datën 31.12.2017**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projekt Vendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet dhe komentet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi, Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

### V E N D O S A:

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të “Auditimit të përputhshmërisë, të ushtruar në Bashkinë Pustec”, sipas programit të auditimit nr. 486/1, prot., datë 02.05.2018, për veprimtarinë nga data 01.01.2016, deri më datën 31.12.2017.

**II.** Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

## A. OPINIONI I AUDITUESIT

### **Opinion i kualifikuar**

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Pustec, bazuar në rezultatet e auditimit, të cilat në mënyrë të përmbledhur janë paraqitur në seksionin, “Gjetje dhe rekomandime”, si dhe mbështetur në ISSAI 100 “Parimet Themelore të Auditimit në Sektorin Publik”, ISSAI 400 “Parimet themelore të Auditimit të Përputhshmërisë” dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale (të rëndësishme), por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar.<sup>1</sup>

### **Baza për dhënien e opinionit të kualifikuar**

Në përfundim të punës audituese rezultoi se në Bashkinë Pustec, nuk është ngritur dhe implementuar si duhet sistemi kontrollit të brendshëm. U konstatuan anomali dhe mos përputhje në hartimin e buxhetit vjetor, mos përputhje midis projekt buxhetit afatmesëm dhe buxhetit vjetor, si dhe nuk është planifikuar shlyerja e detyrimeve të prapambetura për 34 fatura në vlerën totale 6,191,199 lekë.

Në fushën e taksave dhe tarifave vendore nuk janë ndjekur procedurat e plota ligjore për arkëtimin e detyrimeve tatimore dhe si rezultat janë krijuar debitorë në vlerën totale 3,622,619 lekë. Pasqyrat financiare për llogaritë e aktiveve afatgjata, nuk japin gjendjen e saktë të pasurisë së institucionit, sepse nuk është kryer inventarizim i aktiveve afatgjata për vitin 2016 dhe 2017.

Llog. 210 “Toka, troje, terrene” nuk pasqyrohet në bilancin e njësisë vendore edhe pse në fakt institucioni ka pasuri të tilla. Nuk janë ndjekur hapat ligjor për rregjistrimin e pronave të njësisë vendore në ZVRPP dhe nuk është hartuar regjistri i aktiveve.

## B. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Pustec nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për funksionimin e institucionit. Nuk janë hartuar rregulla për ruajtjen e aktiveve, nuk janë hartuar rregulloret e kodit të etikës, arkivës, regjistri i riskut, gjurma e auditimit. Nuk janë hartuar programe dhe nuk janë kryer trajnime për ngritjen e aftësisë profesionale të punonjësve. Ka mangësi të stafit në njohjen e kuadrit rregullator të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 42, të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 8, 16, 22, 23 dhe 24, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (*Më hollësisht trajtuar në pikën A.3.1, faqe 14-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë, Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, të marrin masa për hartimin e dokumentit të gjurmës së auditimit, llojeve të deklaratave dhe shpeshtësisë së tyre. Të hartohet rregullore për etikën, arkivat dhe programe trajnime për punonjësit për rritjen e tyre profesionale dhe njohjen më të mirë të legjislacionit në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

**Deri në 30 nëntor 2018**

<sup>1</sup> Auditimi i përputhshmërisë përcakton se deri në çfarë mase subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara, apo kushtet e përcaktuara, si kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshje financimi.

Kur gabimet janë materiale por jo të përhapura, audituesi paraqet një opinion të kualifikuar

**2. Gjetje nga auditimi:** Si rezultat i punës së pa mjaftueshme të zyrës së taksave dhe tarifave vendore, në fund të vitit 2017, rezultojnë debitorë për taksa dhe tarifa vendore në **vlerën totale 3,622,619 lekë**, e cila përbëhet nga detyrimet e 17 subjekteve privat në shumën 251,070 lekë dhe vlera 3,371,549 lekë detyrime për taksat dhe tarifavat vendore nga taksapaguesit familjar.

Sektori i taksave dhe tarifave vendore nuk ka ndjekur procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e debitorëve, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, nenet 90 dhe 91, të ligjit nr. 9920, ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe pika 12 të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve” (*Më hollësisht trajtuar në pikën B.1.4, faqe 26-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1. Rekomandim:** Nga Sektori i Financës dhe Sektori i Taksave në Bashkinë Pustec, të merren masa për arkëtimin e detyrimeve tatimore dhe të bëhen njoftim vlerësimet tatimore, për 17 subjekte debitorë në shumën 251,070 lekë, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar, duke **ndjekur rrugët e mëposhtme:**

**a.** Tu dërgohen bankave urdhra bllokimi për llogaritë bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

**b.** Të dërgoj në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

**c.** Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, të llogaritet kamat vonesa (gjobë në masën 0,06 % kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

**2.2. Rekomandim:** Sektori i taksave dhe tarifave vendore të marrë masa për hartimin e listës elektronike për abonentët familjare, sipas të dhënave të Gjendjes Civile, si dhe të kërkojë arkëtimin e **vlerës 3,371,549 lekë**, duke dërguar njoftim vlerësimet abonentëve familjarë me nëpërmjet postës, për:

- taksë toke për 867 familje me vlerë 1,303,918 lekë;
- taksë ndërtese për 643 familje me vlerë 401,390 lekë;
- taksë trualli për 643 familje me vlerë 2,250 lekë;
- tarifë pastrimi për 554 familje me vlerë 1,385,500 lekë;
- tarifë ndriçimi për 554 familje me vlerë 278,491 lekë.

**Deri në 30 tetor 2018**

**3. Gjetjet nga auditimi:** Në Bashkinë Pustec, për periudhën 2016 dhe 2017, janë evidentuar 5 subjekte të cilat ushtrojnë veprimtari biznesi pa qenë të regjistruara në QKR. Sektori i taksave dhe tarifave vendore për këto subjekte nuk ka plotësuar njoftim vlerësime, me pasojë mos arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifavat vendore, veprime në papajtueshmëri me nenin 40, 41, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën B.1.4, faqe 26-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1. Rekomandim:** Sektori i taksave dhe tarifave vendore, për subjektet e paregjistruara në QKR të njoftojnë zyrtarisht Drejtorinë Rajonale Tatimore Korçë dhe në rastet e konstatimit të subjekteve që zhvillojnë aktivitet në teritorin e njësisë vendore pa u regjistruar, të marrë të gjitha masat e duhura për regjistrimin e tyre në QKR, duke vendosur sanksione dhe llogaritur detyrimet tatimore edhe për periudhën e pa regjistruar.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**4. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Pustec, nuk ka funksionuar sektori i administrimit të pronave të Bashkisë, si dhe nuk janë ngritur grupe pune për inventarizimin, evidentimin dhe regjistrimin e pronave të Bashkisë. Nuk ka një listë inventarizimi dhe nuk është hapur regjistër kontabël për pronat e njësisë vendore, nuk janë marr masat e nevojshme ligjore për përgatitjen e dokumentacionit dhe regjistrimin e tyre në ZRPP. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 (*Më hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 55-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4.1. Rekomandim:** Bashkia Pustec, të marrë masa për hartimin e listës së inventarizimit të pronave të njësisë vendore, të bëjë verifikimin e statusit të tyre juridik në teren, të përgatisë dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin e tyre në ZVRPPP. Gjithashtu të bëhet regjistrimin e tyre në librin e llogarive sipas rregullave kontabël dhe hartimi i regjistrit të aktiveve.

#### **Deri në fund të vitit 2018**

**5. Gjetje nga auditimi:** Në tre raste të blerjeve të mallrave dhe shërbimeve me vlera të vogla, për rikonstrukcion, mirëmbajtje dhe blerje materiale me vlerë totale 747,700 lekë (urdhër shpenzim nr. 131, datë 23.09.2016, në shumën 139,500 lekë, urdhër shpenzim nr. 153, datë 02.11.2016, në shumën 398,400 lekë dhe urdhër shpenzim nr. 21, datë 13.02.2017, në shumën 209,800 lekë), bashkëlidhur urdhër shpenzimit, nuk ndodhet licenca e operatorit ekonomik, kontrata e lidhur ndërmjet palëve, ku të përcaktohet natyra e shërbimit, objekti, qëllimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit, që do kryhet, marrja në dorëzim nga komisioni i bashkisë, veprim në papajtueshmëri me shkronjën (a) pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, me pikën 42, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën B.1.4, faqe 34-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**5.1 - Rekomandim:** Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues, të marrin masa për plotësimin me dokumentacionin e nevojshëm të tre praktikave të mësipërme të blerjeve me vlera të vogla, respektivisht: licencën e operatorit ekonomik, kontrata e lidhur ndërmjet palëve, situacioni përfundimtar i punimeve edhe procesverbal i marrjes në dorëzim nga komisioni i bashkisë. Në raste të tjera të ngjashme nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të mos bëhet likuidimi i operatorit ekonomik nëse ka mungesa të dokumentacionit vërtetues.

#### **Në vijimësi**

**6. Gjetje nga auditimi:** Në dy raste të blerjes nëpërmjet procedurës me vlera të vogla, materialet me vlerë 363,800 lekë janë vendosur në destinacionin e tyre, pa u kryer procedura e marrjes në dorëzim me procesverbal dhe pa u bërë hyrje në magazinë, veprim në kundërshtim me pikën 37 dhe 41, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën B.1.4, faqe 28-35 të Projekt Raportit të Auditimit*).

**6.1. Rekomandim:** Bashkia Pustec, në të gjitha rastet e blerjes së materialeve, përpara vendosjes së tyre për destinacionin e caktuar, të dokumentojë marrjen e tyre në dorëzim me procesverbal, të bëjë materialet hyrje në magazinë dhe pas daljes së urdhrit të titullarit, nëpërmjet fletëdaljes të kryej daljen e mallrave për në destinacionin fundor.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**7. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Pustec nuk ka kryer inventarizim të aktiveve afatgjata për vitin 2016 dhe 2017.

-Llogaria 202 “Studime e projekte” e cila ka vlerën 2,323,633 lekë dhe përfaqëson vlerën e studimeve dhe projekteve të financuara për vepra të cilat kanë përfunduar, por nuk janë bërë rregullimet përkatëse për kalimin e vlerës së projektit në vlerën e investimit.

-Llog. 210 “Toka, troje, terrene” edhe pse konkretisht Bashkia ka pasuri të tilla, në bilanc është në vlerën 0 lekë.

Nga auditimi konstatohet se me VKM nr.103, datë 3.2.2008, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në Komunën Liqenas të qarkut Korçë”, (ish Komunë e cila sot është Njësia e re Administrative Bashkia Pustec), i është miratuar inventari i listës së pronave, por nga Bashkia Pustec nuk janë ndjekur hapat ligjor për regjistrimin e këtyre pronave në ZVRPP, e si rrjedhim mungon paraqitja e tyre në llogarinë përkatëse të bilancit.

Llogaria “Pyje kullota në bilanc është në vlerën 1,793,836, por nuk ka listë për përbërjen e këtyre aseteve. Për të argumentuar vlerën e aktiveve afatgjata në bilanc u paraqitën lista të këtyre aktiveve, të cilat nuk kanë konfirmimin e asnjë komisioni inventarizues. Për të gjitha arsyet e mësipërme pasqyrat financiare për llogaritë e aktiveve afatgjata, nuk japin gjendjen e saktë të pasurisë së institucionit, në kundërshtim me kërkesat e nenin 7, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre, si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj” i ndryshuar; të UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli III (Më hollësisht trajtuar në pikën A.3.2, faqe 16-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1. Rekomandim:** Nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të merren masa për inventarizimin e aktiveve afatgjata, regjistrimin e tyre, hartimin e listave të inventarëve të këtyre aktiveve, pasqyrimin e vlerave të tyre reale në kontabilitetin dhe pasqyrat financiare të vitit 2018. Të sistemohet llogaria 202 “Studime e projekte”, duke kaluar kjo vlerë në investimet e kryera e të përfunduara.

### **Përpara hartimit të pasqyrave financiare të vitit 2018**

**8. Gjetje nga auditimi:** Institucioni Bashkia Pustec nuk ka krijuar njësi të auditit të brendshëm publik, por është lidhur akt marrëveshje për këtë qëllim me Bashkinë Devoll, nëpërmjet shkresës nr.173 prot., datë 24.01.2017, ku sipërmarrësi për kryerjen e auditit të brendshëm për Bashkinë Pustec është Bashkia Devoll. Edhe pse kjo marrëveshje është dërguar në Ministrinë e Financave dhe është miratuar prej saj qysh në muajin shkurt 2017, konkretisht nuk është kryer asnjë auditim në Bashkinë Pustec, duke mos u vënë në funksionim marrëveshja e kryer, në kundërshtim me nenin 10, të ligjit 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” (Më hollësisht trajtuar në pikën A.3.1, faqe 14-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1. Rekomandim:** Titullari dhe Nëpunësi Autorizues i Bashkisë Pustec, të marrin masa për konkretizimin e marrëveshjes së kryer me Bashkinë Devoll për funksionimin e njësisë së auditit të brendshëm prej saj, duke kërkuar kryerjen prej kësaj të fundit të auditimeve konkrete në Bashkinë Pustec, si dhe të vazhdojë përpjekjet për krijimin e Njësisë së Auditit të Brendshëm në Bashki.

### **Deri në fund të vitit 2018**

**9. Gjetje nga auditimi:** Në hartimin e buxhetit vjetor në zërin e shpenzimeve, nuk janë planifikuar detyrimet e prapambetura. Në këtë zë ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit. Në total treguesit e buxhetit për këtë zë janë realizuar në masën 60 % në vitin 2016 dhe 80% në vitin 2017, nga i cili zëri “Investime”, është realizuar me vlerën më të ulët, respektivisht në masën 20% dhe 70%. Planifikimi i zërave të shpenzimeve dhe investimeve dhe mos realizimi i tyre për shkak të mos realizimit të të ardhurave sjellin mos plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës së njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve.

Nuk është hartuar PBA për vitin 2016. Në hartimin dhe zbatimin buxhetit vjetor të vitit 2017 nuk ka rakordim me PBA e hartuar për këtë periudhë, pasi buxheti i vitit 2017 nuk ka përputhje me vitin e parë të PBA së hartuar. Bashkia Pustec më datën 31.12.2017 ka 34 fatura të pa likuiduara në vlerën totale 6,191,199 lekë, e cila përfshin edhe detyrime të vitit 2013 të mbartura nga ish Komuna Pustec në vlerën 370,720 lekë dhe pjesa tjetër për shumën 5,820,479 lekë janë detyrime të krijuara gjatë aktivitetit të Bashkisë për periudhën 2015-2017. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e metodologjisë së planifikimit të buxhetit dhe nenin 52, -Kryerja e shpenzimeve, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura" (*Më hollësisht trajtuar në pikën B, faqe 20-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**9.1. Rekomandim:** Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Pustec të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm e objektiv të të ardhurave. Të hartohen çdo vit PBA dhe buxheti vjetor të ndjek parashikimin e vitit të parë të PBA.

Në vazhdimësi çdo faturë shpenzimesh të likuidohet brenda afateve ligjore, duke shmangur transferimin e detyrimeve nga njëri vit buxhetor në tjetrin.

**9.2. Rekomandim:** Bashkia Pustec, zyra e financës, të marrë masa të menjëhershme për pagesën e faturave të pa likuiduara në vlerën totale 6,191,199 lekë. Për këtë, bazuar në UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura" dhe Udhëzimin Plotësues nr. 02, datë 10.01.2018 "Për buxhetin e vitit 2018", pikat 82-91-Detyrimet e prapambetura të Njësitve të Vetëqeverisjes Vendore, të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë grafik për shlyerjen e tyre, në përputhje me kërkesat ligjore për radhën e pagesave.

### **Me hartimin e PBA dhe buxhetit të vitit 2018 e në vijimësi**

**10. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Pustec, në pozicionin e punës së Kryeinspektorit të Inspektoriatit e Mbrojtjes së Territorit Vendor, për periudhën 2016-2017, rezulton se është emëruar një punonjës me arsim të lartë dega histori, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar, neni 11 "Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit", ku përcaktohet se: "Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit" (*Më hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 57-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**10.1. Rekomandim:** Bashkia Pustec, kundrejt procedurave të rekrutimit të stafit, të marrë masa për emërimin në pozicionin e punës së Kryeinspektorit të Inspektoriatit e Mbrojtjes së Territorit Vendor të një punonjësi me formimin e duhur arsimor, në mënyrë që të rritet performanca dhe cilësia e punës së këtij sektori.

### **Deri në fund të vitit 2018**

**11. Gjetje nga auditimi:** Ish Komuna Pustec është audituar nga KLSH sipas programit të auditimit nr.25/1 prot., datë 06.03.2015 dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes janë dërguar me shkresën nr. 256/6 prot., datë 18.06.2015. Për arsye të reformës administrativo-territoriale të drejtat dhe detyrimet e ish komunës kanë kaluar në Bashkinë Pustec dhe në këtë mënyrë ka detyrimin ligjor për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH për ish komunën. Zbatimi i rekomandimeve është audituar nga KLSH sipas programit të auditimit nr. 1015, datë 03.11.2015 dhe në Raportin përfundimtar të këtij auditimi është rikërkuar zbatimi i rekomandimeve të pa zbatuara. Nga auditimi u konstatua se nga 10 masa për shpërbllim dëmi në

vlerën totale 1,241,072 lekë, është zbatuar pjesërisht 1 masë, me vlerën e realizuar të arkëtimit 62,500 lekë. Për 9 masa të tjera janë nxjerrë urdhrat e titullarit, por nuk është arkëtuar detyrimi dhe nuk janë marrë masa të tjera, duke mos ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin i detyrimit në vlerën totale 1,178,527 lekë, ende i pa arkëtuar. Nuk është bërë kontabilizimi në pasqyrat financiare i detyrimit për shpërblimin e dëmit ekonomik të lënë në rekomandimet e KLSH-së (*Më hollësisht trajtuar në pikën H, faqe 62-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**11.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Pustec, Zyra juridike dhe Nëpunësi zbatues, të hartojnë plan pune të veçantë e të marrin të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara të KLSH në auditimin e mëparshëm, në vlerën totale 1,178,527 lekë. Nga nëpunësi zbatues, bazuar mbi urdhrat e nxjerrë nga titullari të bëhet kontabilizimi i detyrimeve të pa arkëtuara.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

### **C.1. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH-së*, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Titullari i Njësisë Publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **2,159,645 lekë**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Në objektin “Rikonstruksion, sistemim-asfaltim rruga K/Korçë - Goricë - Gollomboç” me vlerë të kontratës 17,820,447 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2017, nga auditimi i projektit, dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike, rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **338,920 lekë pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik** për buxhetin e shtetit dhe të njësisë vendore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 224 prot., datë 18.05.2017, të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Pustec dhe OE “**B. B.**” SHPK (*Më hollësisht trajtuar në pikën C.1.4., faqe 49-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Pustec të merren të gjitha masat e nevojshme ligjore, për arkëtimin e vlerës **338,920 lekë pa TVSH** nga operatori ekonomik “**B. B.**” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve, sipas kontratës së punimeve nr. 224 prot., datë 18.05.2017.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Bashkisë Pustec, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor me subjektin “**T. A**” SHA, ka lidhur kontratë qiraje nr. 29108, datë 09.04.2008, për sipërfaqe 300 m<sup>2</sup>, kontratë nr. 28/17, datë 09.04.2017, për sipërfaqe 205 m<sup>2</sup> dhe kontratë nr. 66/08, datë 12.11.2009, për sipërfaqe 150 m<sup>2</sup> për ndërtim të stacionit të antenave. Po ashtu me subjektin “**E. M.**” SHA, ka lidhur kontratë qiraje nr 1005, datë 15.06.2011, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor publik për sipërfaqe 200 m<sup>2</sup> për ndërtim të stacionit të antenave, vlerat e kontratës janë llogaritur sipas VKM nr. 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064,

datë 22.12.2010 “ Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhjes 2, pika 6 “Për vendosje antene”. Nga të dhënat e marrë në zyrën e financës, rezulton se këto subjekte deri më datën 31.12.2017 e në vazhdim, nuk kanë likuiduar detyrimet e kontratave në vlerën **668,625 lekë, dëm ekonomik** për buxhetin e njësisë vendore (të ardhura të munguara). Kjo vlerë përbëhet nga detyrimi i subjektit “**T. A.**” **SHA** në vlerën 368,625 lekë dhe subjektit “**E. M.**” **SHA** në vlerën 300,000 lekë. Veprimet e mësipërme janë në papajtueshmëri me kushtet e kontratave të lidhura dhe pranuar ndërmjet palëve dhe nenin 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiarë dhe Kontrollin” (*Më hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 55-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1 - Rekomandimi:** Bashkia Pustec të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **368,625 lekë** nga subjekti “**T. A.**” **SHA** dhe vlerës **300,000 lekë** nga subjekti “**E. M.**” **SHA**, duke llogaritur edhe penalitetet përkatëse.

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se për periudhën 2016-2017, për 33 punonjës të Bashkisë Pustec, janë bërë pagesa për udhëtim e dieta në vlerën totale **1,152,100 lekë**, dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë. Bashkangjitur urdhër shërbimeve nuk ka dokumentacion vërtetues, autorizim dhe program pune për qëllimin e shërbimit të miratuar nga titullari i institucionit veprim në papajtueshmëri me pikën 1, kreu III, të VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën B.1.4, faqe 32-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1. Rekomandimi:** Bashkia Pustec të marrë të gjitha masat e nevojshme ligjore, për arkëtimin e vlerës **1,152,100 lekë**, nga 35 personat përfitues, sipas listës së lënë nga KLSH në aneksin nr.2/2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Menjëherë**

## **C.2 MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE**

**1. Gjetje nga auditimi :** Nga shqyrtimi i projektit të zbatimit, relacionit teknik dhe preventivit të realizuar nga projektuesi z. **K. Sh.** për objektin “Rikonstruksion, sistemim-asfaltim rruga K/Korçë-Goricë-Gollomboç” Bashkia Pustec, rezultoi se zëri “Spërkatje me bitum 1 lit/m<sup>2</sup>”, me sasi 4112 m<sup>2</sup> dhe çmim 171 lekë/m<sup>2</sup>, me vlerë totale 703,152 lekë pa TVSH, është i paargumentuar teknikisht, pasi ky zë pune, bazuar në analizat e çmimeve sipas manualeve, është i përfshirë në zërat e shtresave asfaltike dhe paraqitja e tij si zë më vete, mbi një shtresë të re joasfaltike, edhe pse është shpenzuar realisht, nuk është i justifikuar teknikisht. Për pasojë, fondi limit është rritur në mënyrë të pa dobishme në vlerën **703,152 lekë** pa TVSH, e cila përbën përdorim pa ekonomikitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike (*Më hollësisht trajtuar në pikën C.1.4, faqe 49-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1. Rekomandim:** Autoriteti Kontraktor Bashkia Pustec, të marrë masa nëpërmjet strukturave të prokurimit, që para publikimit të procedurës së prokurimit, të kontrollojë dhe analizojë projekt preventivin, në mënyrë që zërat e punës të jenë sipas manualit të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe fondi limit të jetë sa më afër kostos reale të zbatimit.

**Menjëherë dhe në vijimësi**



**2. Gjetje nga auditimi:** Si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore, në një rast në vitin 2017, janë shpenzuar fonde publike në vlerën 318,400 lekë, me pasojë efekt negativ në buxhetin e njësisë vendore për arsye se nuk janë ndjekur si duhet nga institucioni procedurat ligjore për largimin e punonjësve nga puna.

**Rekomandim:** Titullar dhe zyra juridike, në të gjitha rastet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me punonjësit e institucionit, si dhe në raste të tjera të ngjashme, të ndjekin të gjitha procedurat e duhura ligjore, me qëllim shmangien e kostove financiare në buxhetin e njësisë vendore, nga zbatimi i vendimeve gjyqësore (*Më hollësisht trajtuar në pikën B, faqe 24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

## **D. MASA DISIPLINORE**

### **D.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.**

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 58, “llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe, nenin 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Pustec që ti kërkojë Komisionit Disiplinor të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

**“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet“, për 1 punonjës:**

**1. Z. C. N.**, me detyrë përgjegjës i financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe kryetarit të komisionit me blerje të vogla, *për shkeljet e mëposhtme:*

- Për mos krijimin e regjistrit të aktiveve të njësisë vendore;
  - Për mos përfshirjen në buxhetin vjetor të detyrimeve afatshkurtra ndaj të tretëve dhe mos hartimin e buxhetit vjetor në përputhje më PBA për vitin 2016 dhe 2017 dhe mos likuidimin e faturave të prapambetura në vlerën 6,191,199 lekë;
  - Për mos kryerjen e inventarizimit të aktiveve afatgjata për vitin 2016 dhe 2017;
  - Për mos paraqitje të vlerave të sakta në bilanc për llogarinë 202 “Studime e projekte” dhe llogarinë 210 “Toka, troje, terrene”;
  - Për kryerje të pagesave për udhëtim e dieta pa dokumentacion vërtetues, për 33 punonjës të njësisë vendore në vlerën totale 1,152,100 lekë
- në dy raste të blerjes së materialeve me vlerë 363,800 lekë nuk janë marrë në dorëzim, nuk janë bërë hyrje në magazinë;
- në tre raste për rikonstruksion, mirëmbajtje dhe blerje materialesh me vlerë 747,700 lekë bashkëlidhur nuk ndodhet licenca e operatorit ekonomik, kontrata e lidhur ndërmjet palëve, ku të përcaktohej natyra e shërbimit, objekti, qëllimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do kryhet.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e metodologjisë së planifikimit të buxhetit dhe nenin 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kërkesat e nenin 7, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, kërkesat e pikës 37, 41, 42, kapitullit III, të UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

## **D.2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës.**

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjat “e” dhe “ç” të nenit 1, kreun IV, dhe nenet 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të nenit 15 të kontratës individuale të punës, **i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë**, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH për periudhën 01.01.2016 deri më 31.12.2017, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, **për 9 punonjësit e mëposhtëm:**

### **I. Masën disiplinore “Vërejtje”, për:**

**1. Zj. M. S.**, me detyrë përgjegjëse e sektorit të taksave dhe tarifave vendore për shkeljet e mëposhtme:

- Për mos ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e debitorëve në vlerën 3,622,619 lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenet 90, 91, të ligjit nr. 9920 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;

**2. Z. A. T.**, me detyrë inspektor i taksave dhe tarifave vendore, në cilësinë e kryetarit të komisionit të prokurimit me vlera të vogla;

**3. Zj. A. J.**, me detyrë specialiste e shërbimeve dhe arkëtare, në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimit me vlera të vogla, për shkeljet e përbashkëta të mëposhtme:

-në dy raste të blerjes së materialeve me vlerë 363,800 lekë nuk janë marrë në dorëzim, nuk janë bërë hyrje në magazinë;

-në tre raste për rikonstruksion, mirëmbajtje dhe blerje materialesh me vlerë 747,700 lekë bashkëlidhur nuk ndodhet licenca e operatorit ekonomik, kontrata e lidhur ndërmjet palëve, ku të përcaktohej natyra e shërbimit, objekti, qëllimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do kryhet.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e pikës 37, 41, 42 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar dhe germa a pika 1 kreu VI, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimeve publike”, të ndryshuar.

**4. Z. A. C.**, me detyrë k/inspektor ndërtimi, në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të fondit limit;

**5. Z. I. M.**, me detyrë specialist finance, në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të fondit limit;

**6. Zj. N. A.**, me detyrë specialiste pagash, në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të fondit limit, për shkeljet e përbashkëta të mëposhtme:

Në tenderin me objekt “Blerje makine (fadromë)”, zhvilluar në datën 18.04.2016 kanë përcaktuar fondin limit pa zbatuar asnjë nga metodat ligjore për përlllogaritjen reale të tij, në kundërshtim me nenin 59 të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**7. Zj. S. Q. (M.)**, me detyrë specialiste e burimeve njerëzore, në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit.

**8. Zj. E. J.**, me detyrë sekretare këshilli, në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit.

**9. Z. N. K.**, me detyrë specialist i prokurimeve dhe IT, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për shkeljet e përbashkëta të mëposhtme:

Në tenderin me objekt “Blerje makinë (fadromë)”, zhvilluar në datën 18.04.2016 hartimi i kriteve të veçanta dhe specifikimeve teknike është bërë në kundërshtim me kërkesat e pikës 5, nenit 23 “Specifikimet teknike”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

## **E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL**

Për punonjësit të cilët do të jepet masë disiplinore për sa më sipër, Bashkia Pustec, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

**a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

**b.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

**BUJAR LESKAJ**

**K R Y E T A R**